

OLIVER JENS SCHMITT

**KOSOVA**  
HISTORI E SHKURTËR E NJË  
TREVE QENDRORE BALLKANIKE

KOHA,  
Prishtinë, nëntor 2012

**Titulli i originalit:**

Kosovo: Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft

**Autor:**

OLIVER JENS SCHMITT

**Përktheu nga originali gjermanisht:**

ENVER ROBELLI

**Lektor:**

NEHAT SPAHIU

**Biblioteka**

ELEFANS

**Redaktore e bibliotekës:**

FLAKA SURROI

**Përgatitja teknike:**

LUAN TASHI

© 2012 Oliver Jens Schmitt

© Të drejtat botërore: 2008 by Böhlau Verlag Ges.m.b.H.  
und Co. KG, Wien – Köln – Weimar

© Për botimin shqip, 2012 KOHA, Prishtinë, Republika e Kosovës

© Për përkthimin: S. Fischer, Foundation me porosi të TRADUKI-t

**BOTUES**

KOHA, Prishtinë

Tirazhi: 2000 kopje

botimetkoha@koha.net

**T** “Ky libër u mundësua falë ndihmës së TRADUKI-t, një rrjet për letërsi, i nisur bashkërisht nga Ministria e Marrëdhënieve Evropiane dhe Ndërkombëtare e Austrisë, Ministria e Jashtme e Gjermanisë, Këshilli Zviceran i Artit *Pro Helvetia*, *KulturKontakt*, Austri, Instituti *Goethe*, Agjencia Sllovene e Librit JAK dhe Fondacioni *S. Fischer*”.

OLIVER JENS SCHMITT

**KOSOVA**  
HISTORI E SHKURTËR E NJË  
TREVE QENDRORE BALLKANIKE

**Biblioteka ELEFANS**

**Noel Malcolm**

KOSOVA

Histori e shkurtër

**Marc Weller**

SHTETËSIA E KONTESTUAR

Administrimi ndërkombëtar i luftës së Kosovës për pavarësi

**Stephen Schwartz**

ISLAMI TJETËR

Sufizmi dhe rrëfimi për respektin

**Stacy Sullivan**

MOS KIJ FRIKË, SE I KE DJEMTË NË AMERIKË  
Si e futi pullazxhiu Amerikën në luftë në Kosovë

**FADIL HOXHA NË VETEN E PARË**

(me shënime dhe parathënie të Veton Surroit)

**Tim Weiner**

TRASHËGIMI PREJ HIRI

Historia e CIA-s

**Vanessa Redgrave**

AUTOBIOGRAFIA

**Robert C. Austin**

NOLI DHE NJË REVOLUCION I IKUR

**Veton Surroi**

LIBRI I FLUTURAVE

**Blerim Shala**

LIBRI I FITORËS 1 & 2

SHTETI I SHKELUR





Studentëve të mi shqiptarë dhe serbë

Përmbajtja

Parathënia e botimit në gjuhën shqipe  
Parathënia e botimit në gjermanisht  
Kronologjia  
Hyrje  
Koncepte konkurruese të historisë  
Kosova në konceptin e historisë serbe  
Imazhi shqiptar i Kosovës  
Kosova si hapësirë  
Rëndësia ideologjike e emërtimeve territoriale  
Struktura e banimit  
Qafa malesh dhe rrugë

Kreu i parë  
Sundues dhe të sunduar në kohën paramoderne:  
kufijtë e pushtetit perandorak

Sundimi perandorak

Sundimi perandorak: Roma  
Sundimi perandorak: Bizanti

Në kapërcyellin mes dy perandrive  
Sundimi serb në mesjetë  
Beteja e parë në Fushë-Kosovë, më 28 qershor 1389 – ngjarja  
historike dhe rimodelimi i saj në mit kombëtar  
Fundi i shtetësisë serbe  
Sundimi perandorak: Perandoria Osmane  
Myslimanë dhe zimmis (jomyslimanët)  
Tatimpagues dhe të privilegjuar  
Ushtria si mjet integrimi  
Një shoqëri në shërbim të aparatit luftarak  
Strukturat administrative osmane  
Sundimi indirekt në viset periferike  
Botët e ndara të Perandorisë  
Fuqia e drejtësisë së traditës gojore  
E drejta e Perandorisë dhe e drejta religjioze



Zbatimi i së drejtës:

Dy raste si shembuj nga rajoni i Deçanit

Kultura materiale si faktor i unifikimit perandorak

Eksperimenti i integritetit perandorak në shekullin e 19-të

Myslimanët e Kosovës si kundërshtarë reformash

Kosova nën sundimin perandorak –

Përpjekje për një krahasim me sistemin shtetëror dhe distancën ndaj shtetit para vitit 1912

Kosova si qendër dhe periferi

Jeta sociale

Shoqëria, ekonomia, ambienti

Shoqëria

Familja

Gjinia

Të fuqishmit dhe të dobët

Vendas/vendasve dhe seminomadë

Mali dhe luginat – qyteti dhe fshati

Ekonomia

Klima

Bota kulturore

Religjionet dhe gjuhët

Religjionet dhe konfesionet

Një trevë e lashtë e krishterë

Islamizimi si proces shumëshekullor

Tarikati i dervishëve

Të krishterët ortodoksë

Katolikët

Religjioziteti dhe besimi popullor

Gjuhët

Historia e popullsisë dhe shpërnguljet

(Proto)shqiptarët, vllahët dhe sllavët në mesjetën e hershme

Strukturat e popullsisë në mesjetën e mesme dhe të vonshme

Çështje metodike të analizimit të burimeve  
Lëvizjet e popullsisë në epokën e re të hershme  
“Shpërngulja e madhe” e serbëve (1690) në histori dhe në mit  
Shpërnguljet në shekujt e 18-të dhe të 19-të (deri më 1878)  
Grupet e vogla të ardhacakëve: romët dhe çerkezët  
Muhaxhirët dhe lindja e tensioneve etnofetare  
Struktura fetare dhe etnike e Kosovës rreth vitit 1880  
Modele të etnizuara dhe tradicionale të identitetit  
Bullgarë apo serbë? Nacionalizimi i identitetit të ortodoksëve jugorë  
sllavishtfolës  
“Serbia e vjetër” – krijimi i epërsisë serbe në interpretimin e Kosovës  
dhe shoqërisë saj  
“Kosova si qendër e lëvizjes kombëtare shqiptare”

Kreu i dytë  
Kosova në Serbi dhe në dy Jugosllavitë (1912-1999)

Kosova në Serbi  
Dhuna dhe lufta si faktorë në historinë më të re të Kosovës  
Çështja e tërheqjes së kufijve dhe qëndrimi i fuqive të mëdha  
Administrata serbe dhe malazeze e Kosovës (1912-1915)  
Lufta e Parë Botërore dhe fundi i përkohshëm i administratës serbo-  
malazeze

Kosova në Jugosllavinë e parë

Politika e Serbisë ndaj popullsisë së Kosovës  
Qëndrimi i popullsisë shumicë shqiptare ndaj Mbretërisë Serbo-  
Kroato-Slllovene  
Përpjekja e dështuar për integrimin e parisë myslimane  
Lëvizja kryengritëse shqiptare 1918-1924  
Roli i Shqipërisë  
Kosova si territor kolonial  
Programi serb i kolonizimit  
Shpërngulja dhe dëbimi  
Kushtet e jetesës dhe arsimit  
Diskursi serb mbi shqiptarët  
Jugosllavia e parë dhe Kosova – përpjekje për një bilanc

Kosova në Luftën e Dytë Botërore

Kosova në Jugosllavinë e dytë

Konflikti shqiptaro-serb në Kosovë në vitin 1945

Shqipëria komuniste dhe çështja e Kosovës

Periudha e Rankovićit (1945-1966)

Kthesa në politikën jugosllave ndaj Kosovës

Eksperimenti i dështuar i një kombi “šiptar” në Jugosllavi

Eksperimenti socialist

Ofensiva e arsimimit

Arsimimi i elitës shqiptare

Industrializimi

Krijimi i shtresës së punëtorëve

(R-)Urbanizimi dhe transformimi shoqëror

Ndryshimet në kulturën materiale

Ambientet e jetës së përditshme socialiste

Shëndetësia dhe zhvillimi i popullsisë

Nismat për emancipimin e femrës

“Kosova në vitin 2000”

Krijimi i identitetit etnonacional shqiptar si fenomen masiv

Procese të tjera të nacionalizimit në Kosovë

Emigrimi masiv dhe krijimi i diasporës shqiptare të Kosovës

Rëndësia ekonomike dhe politike e diasporës

Problemet e integrimit

Krimi i organizuar

Historia politike:

Prej vdekjes së Titos deri te nënshtrimi i Kosovës nga ana e Slobodan

Miloševićit

Kryengritja shqiptare e vitit 1981

Serbët në Kosovë dhe imazhi serb i Kosovës

Nënshtrimi i Kosovës

Kosova në Jugosllavinë e Slobodan Miloševićit

Serbizimi

Krijimi i “shoqërisë paralele” shqiptare dhe rezistenca paqësore

Riorganizimi politik

Kriza ekonomike

Dështimi i rrugës pacifiste dhe ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës

Radikalizimi i rezistencës shqiptare dhe kryengritja e viteve 1998/99

Ndërkombëtarizimi i konfliktit dhe ndërhyrja e NATO-s

Kreu i tretë

Kosova si protektorat ndërkombëtar (1999-2008)

Arratisje dhe dëbime të sërishme

Sistemi sundues i UNMIK-ut

UÇK-ja si forcë politike dhe ushtarake

Eksportimi i ekstremizmit shqiptaro-kosovar

Kryengritja në Luginën e Preshevës

Lufta civile në Maqedoni

Shoqëria paralele serbe e Kosovës

Zhvillimi ekonomik dhe shoqëror

Çështja e strukturave të shoqërisë civile

Qasja ndaj krimeve të luftës në shoqërinë shqiptare të Kosovës

Çështjet e identitetit të shqiptarëve të Kosovës mes laicizmit kombëtar-nacionalist, traditës katolike dhe interpretimit islamik

Riinterpretimi i elementeve kulturore serbe

Importimi i kulturës tradicionale-nacionale të përmendoreve:

Skënderbeu

Fshati si fuqi e interpretimit: kulti për Adem Jasharin

Nëna Terezë dhe tradita katolike

Kosova dhe bota islame

Orienti apo Oksidenti? Debati i parë panshqiptar mbi identitetin kombëtar dhe orientimin kulturor

Dështimi i negociatave dhe Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

Pavarësia e Kosovës dhe frika nga “Shqipëria e madhe”

Bibliografia

## Parathënie për botimin në gjuhën shqipe

Pak më shumë se katër vjet pas botimit në gjermanisht, lexuesi shqiptar merr në dorë këtë libër. Kjo u bë e mundshme falë interesimit të shtëpisë botuese KOHA dhe, para së gjithash, Flaka Surroit, të cilën e falënderoj për zemërsisht për nismën që ky libër të përkthehet në shqip. Enver Robelli ka bërë shumë më tepër, përveç përkthimit brenda një kohe të shkurtër; ai ka bërë vërejtje të rëndësishme, të cilat ndihmuan në korigjimin e gabimeve dhe nuancimin e vlerësimeve mbi trazirat e vitit 1981. Duke pasur këtë parasysh e falënderoj po ashtu për zemërsisht për bashkëpunimin e mirë. Konrad Clewing (Regensburg) i ka bërë disa saktësime të rëndësishme lidhur me disa shifra të diskutueshme. Lexuesi shqiptar nuk po e merr në dorë vetëm përkthimin e librit, por një version të përmirësuar të tij.

Qëllimi dhe metoda e librit janë shpjeguar gjerësisht në hyrje. Por këtu e shoh të udhës t'i japë disa komente, duke pasur parasysh se libri është botuar para më shumë se katër vjetësh. Botimi në gjermanisht është pritur kryesisht me për zemërsi dhe dashamirësi. Megjithatë, ishte interesante të lexosh kritikën e ashpër të një zëri, i cili thoshte se libri u përmbahet "stereotipave kombëtarë shqiptarë\*". Është për të dyshuar që shumë lexues shqiptarë do të jenë të këtij mendimi. Këtu duhet pritur më shumë një kritikë tjetër. Ndonëse libri nuk përpiket që Kosovën ta reduktojë në një histori konflikti mes shqiptarëve dhe serbëve, autori e ka të qartë se disa lexues librin do ta gjykojnë sipas asaj se a do ta gjejnë apo jo brenda tij qëndrimin e tyre politik dhe imazhin e tyre mbi historinë. Ndonëse lexuesi shqiptar ka para vetes përkthimin në shqip, ai duhet ta ketë parasysh që ky libër as nuk është shkruar vetëm për publikun shqiptar, as nuk ka për qëllim që lexuesit gjerman t'i ofrojë "stereotipa kombëtarë shqiptarë". Për më tepër, këtu synohet të ofrohet një paraqitje, e cila e nxit lexuesin shqiptar dhe serb t'i rishikojnë interpretimet e zakonshme dhe njëkohësisht t'i ofrojnë orientim lexuesit, i cili nuk e njuh aq rajonin. Duke pasur parasysh lexuesin në rajon, qëllimi nuk ishte që të bëhej vetëm dekonstruktimi i imazheve të njohura historike shqiptare dhe serbe. Për më tepër, libri, në mënyrë konstruktive, synon të tërheqë vëmendjen se shumë fusha

\* Jahrbücher für osteuropäische Geschichte 59 (2011) 425-427. [Vjetarët e historisë së Evropës Juglindore, 59 (2011), 425-427]

të historisë së Kosovës pothuaj nuk janë trajtuar ende, ndonëse bibliotekat me literaturë shqiptare dhe serbe krijojnë një përshtypje tjetër. Në të vërtetë, në vitet e fundit pas botimit të këtij libri në gjermanisht janë publikuar shumë vepra mbi Kosovën, por mes tyre nuk gjenden zbulime të reja historike. Kështu, ne ende dimë shumë pak për Kosovën në Jugosllavinë e dytë. Në të vërtetë, në gazeta publikohet diçka, por mungojnë punimet shkencore dhe sistematike. Në medime diskutohet shumë për periudhën osmane, por mungojnë po ashtu punime serioze shkencore të osmanistëve.

Historia me të cilën ballafaqohet lexuesi në këtë libër nuk është vlerë e ngurtë apo e vërteta përjetësisht e vlefshme: ajo lind në një proces, në të cilin marrin pjesë historianët. Ky proces jeton nga diskutimi dhe kundërthënia argumentuese. Edhe ky libër është më shumë një ftesë për lexuesin, që historinë dhe historiografinë ta shohë si proces dhe të ballafaqohet me të. Njëkohësisht ky libër është një ftesë sidomos për historianët e gjeneratës së re që të trajtojnë çështje të reja të hulumtimeve dhe të vënë në pyetje shabllonet e vjetra të mendimit. Gjëja më e mirë që mund të bëjë një trajtesë historike është të nxisë një debat të kualifikuar shkencor. Në hulumtimin e historisë së Kosovës ka ende shumë punë për të bërë - të lashtat janë plot drithë dhe presin për t'i korrur, por numri i korrësve të vërtetë ende është i vogël.

Vjenë, tetor 2012

## Parathënia e botimit në gjermanisht

Në historinë evropiane rrallë ndodh që një libër, i planifikuar t'i kushtohet historisë së një rajoni, të tejkalohet nga zhvillimet politike, ashtu që së paku kapitulli i fundit rrëfen fillet e një shteti të krijuar ndërkohë. Kosova është një nga rajonet më të varfra të Ballkanit, rrjedhimisht dhe mbarë Evropës. Deri te shpërthimi i konflikteve të armatosura në dekadën e parafundit Kosova pothuaj nuk e ka tërhequr vëmendjen e opinionit të gjerë publik. Rrjedhimisht, niveli i hulumtimeve është i ulët dhe shpesh i pakënaqshëm. Ky libër e pasqyron këtë situatë që në ndërtimin e tij, me ç'rast së kaluarës së vonshme, e cila është më mirë e hulumtuar, i kushtohet një rëndësi dukshëm më e madhe. Ky libër nuk pretendon të jetë një paraqitje gjithëpërfshirëse në kuptim të një doracaku. Shumë hollësi gjenden të prezantuara gjerësisht në vepra të tjera, të cilat lexuesi do t'i gjejë në fund të këtij libri. Ky tekst synon të ofrojë një vështrim analitik të historisë së një treve qendrore ballkanike, të shpjegojë dhe më pak të rrëfejë. Nëse kjo është arritur së paku sipërfaqësisht, atëherë kjo i detyrohet punës së atyre historianëve, në rezultatet e të cilëve mbështetet ky libër kryesisht. Meqë nuk mund të ofrohet një tërësi referencash (vetëm citatat e fjalëpërfjalshme përmenden shprehimisht), po sjellim këtu emrat e tyre: Peter Bartl, Rafael Biermann, Nathalie Clayer, Konrad Clewing, Ger Duijzings, Eva Frantz, Denisa Kostovicova, Noel Malcolm, Robert Pichler, Jens Reuter, Stephanie Schwandner-Sievers, Holm Sundhaussen dhe Stefan Troebst. Studimet e Grupit Ndërkombëtar të Krizave kanë qenë po ashtu me vlerë të madhe, ndonëse orientimi i tyre politik nuk është marrë parasysh këtu. Dorëshkrimi është lexuar në mënyrë kritike dhe prej perspektivave të ndryshme nga disa kolegë dhe miq; pas vërejtjeve të tyre teksti është pasuruar jashtëzakonisht. Përzemërsisht falënderoj: Nathalie Clayer, Konrad Clewing, Stephan Eder, Eva Frantz, Aleksandar Jakir, Markus Koller, Sándor Rozmán, Stephanie Schwandner-Sievers dhe Arnold Suppan. Të gjitha gabimet dhe vlerësimet janë përgjegjësi e autorit. Ky tekst në pjesën më të madhe buron nga kurset universitare, të cilat autori i ka mbajtur viteve të fundit në universitetet e München, Bernës dhe Vjenës, si dhe në Akademinë Diplomatike në Vjenë. Biblioteka e Institutit të Shqipërisë në München, e cila ka gjetur një vatër të re në Institutin e Historisë së Evropës Juglindore të Universitetit të Vjenës, më ka ofruar kushte të shkëlqyeshme të punës. Teksti është pasuruar dukshëm edhe nga diskutimet e shumta me studentë dhe është shkruar edhe në kujtim të këtyre bisedave, sidomos me studentë nga Evropa Juglindore. Prandaj, ky libër edhe u kushtohet pjesëmarrësve shqiptarë dhe serbë të këtyre kurseve.

Vjenë, prill 2008

## Kronologjia

Shekujt e 6-të e 7-të	Imigrimi i grupeve sllave
Rreth shekullit të 9-të	Sundimi i Perandorisë së Parë Bullgare
Rreth vitit 1018	Integrimi në Perandorinë Bizantine
Në fund të shekullit të 12-të	Fillimi i shtrirjes serbe në jug
1253	Zhvendosja e selisë së mitropolitit serb në Pejë
1346	Kurorëzimi i Stefan Dushanit IV me titullin Car; fronëzimi i mitropolitit serb si Patriark
28 qershor 1389	Beteja e parë në Fushë-Kosovë; fillimi i pushtimit osman
1392	Vendosja e sundimit osman
1448	Beteja e dytë në Fushë-Kosovë; sigurimi përfundimtar i sundimit osman
1455	Përmbyllja e pushtimit osman të Kosovës
1557	Rivendosja e Patriarkatit ortodoks të Pejës, i cili ndërkohë ishte zhdukur
1689/90	Depërtimi i trupave habsburgase në Kosovë; Kryengritja e krishterë kundër osmanëve; ikje masive e popullsisë ortodokse në Perandorinë e Habsburgëve
1737	Kryengritje e sërishme e popullsisë së krishterë dhe ikje e sërishme, para së gjithash, e të krishterëve ortodoksë në territoret habsburgase
1766	Suspendimi i Patriarkatit të Pejës dhe vendosja e Kishës Ortodokse të Kosovës nën administratën e drejtpërdrejtë të Patriarkut të Kostandinopojës
1839-1855	Trazira të myslimanëve shqiptarë kundër reformave (Tanzimatit) në Perandorinë Osmane
1877/78	Lufta ruso-osmane dhe serbo-osmane; dëbimi i myslimanëve shqiptarë nga zonat e Nishit, Leskovcit dhe Vranjës, të cilat u pushtuan nga Serbia
1878	Kongresi i Berlinit; Lidhja e Prizrenit si aleancë mbrojtëse myslimane në territoret kufitare osmane
1899	Lidhja e Pejës
1908	Revolucioni xhonturk në Perandorinë Osmane



1912	Lufta e Parë Ballkanike: pushtimi serb dhe malazez i Kosovës
1915-1918	Administrimi i Kosovës nga Austro-Hungaria dhe Bullgaria
1918	Integrimi i Kosovës në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (nga viti 1929 Jugosllavia)
1918-1924	Kryengritja e armatosur shqiptare (kaçakët)
Periudha mes dy luftërave	Programi serb për kolonizimin e Kosovës
1938	Marrëveshja e Jugosllavisë me Turqinë për shpërnguljen e shqiptarëve
12 gusht 1941	Integrimi i pjesës më të madhe të viseve të Kosovës në Mbretërinë e Shqipërisë të kontrolluar nga Italia; pushtimi gjerman, përkatësisht bullgar në veri përkatësisht në jug të Kosovës
1941-1943	Dëbimi dhe vrasja e kolonëve serbë
1943	Bashkimi i rezistencës komuniste dhe jokomuniste shqiptare në Mukje; plani i një "Shqipërie etnike" me Kosovën
1945	Integrimi i sërishëm i Kosovës në Jugosllavi (si krahinë autonome e Kosovës dhe Metohisë)
1948	Prishja e Titos me Stalinin dhe fundi i planeve për bashkimin e Shqipërisë komuniste me Jugosllavinë
1945-1966	Sundimi i ministrit të brendshëm Aleksandar Ranković; represion kundër popullsisë shqiptare; shpërngulje e një çerek milioni shqiptarësh dhe myslimanësh të tjerë
1966	Rrëzimi i Rankovićit dhe fillimi i federalizmit të Jugosllavisë
1974	Kushtetuta e re e Jugosllavisë i jep Kosovës statusin e Krahinës Autonome me status faktik të Republikës
Që nga viti 1968	Modernizim i përsheptuar ekonomik dhe shoqëror; emigrim i përsheptuar i serbëve
1981	Kryengritje shqiptare në Kosovë pas vdekjes së Titos, pjesërisht e orkestruar nga Shqipëria
1987	Ngjitja në pushtet e Slobodan Miloševićit
1989	Suprimimi i statusit të autonomisë; rezistencë paqësore e popullsisë shqiptare

1990	Shpallja e Republikës së Kosovës brenda bashkësisë shtetërore jugosllave
1991	Shpallja e pavarësisë së plotë të Republikës së Kosovës
Vitet '90	Emigrimi i 400.000 shqiptarëve në Evropën Perëndimore dhe në atë Qendrore
1995	Marrëveshja e Daytonit; çështja e Kosovës nuk trajtohet
1997	Shenjat e para të rezistencës së armatosur shqiptare
1998	Dështimi i kryengritjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)
1998/pranverë 1999	Dëbim gjithëpërfshirës i popullsisë shqiptare nga autoritetet serbe të sigurisë dhe nga paramilitarët
Mars - qershor 1999	Intervenimi i NATO-s kundër Serbisë; tërheqja e forcave serbe të sigurisë; ikja dhe dëbimi i 100.000 serbëve dhe romëve
1999-2008	Administrimi i Kosovës nga Kombet e Bashkuara, në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit
17 shkurt 2008	Deklarata e Pavarësisë së Kosovës; fillimi i misionit të BE-së në Kosovë

## Hyrje

Për shkak të statusit të saj në të drejtën ndërkombëtare dhe konfliktit etnonacional mes shqiptarëve dhe serbëve, Kosova aktualisht gëzon vëmendje të dukshme. E ardhmja e rajonit tani për tani konsiderohet si njëra prej çështjeve të rëndësishme të politikës botërore. Prandaj, viteve të fundit është shkruar një numër tejet i madh i analizave nga prizmi i shkencave politike, por, krahas tyre, ekzistojnë vetëm pak hulumtime shkencore mbi historinë dhe kulturën, të cilat nuk merren vetëm me konfliktet e fundit, por edhe me strukturat e thella sociokulturore të rajonit. Mbase nëntë të dhjetat e të gjitha publikimeve shkencore mbi Kosovën janë shkruar nga shkencëtarët shqiptarë apo serbë, ndërsa vetëm pak prej këtyre punimeve janë të pangjyrosura politikisht. Numri i shkencëtarëve që merret me Kosovën, por të cilët nuk rrjedhin nga rajoni, është modest. Në një pasqyrë të historisë së një rajoni, i cili perceptohet në mënyrë aq kontroverse, studimet ekzistuese duhet të merren parasysh me kujdes, në mënyrë që të evitohet çdo njëanshmëri. Kjo pasqyrë mund të mbështetet në disa sinteza të rëndësishme, të cilat janë përpunuar viteve të fundit nga autorë të veçantë apo nga grupe shkencëtarësh. Shumë nga këto vepra janë shkruar duke pasur parasysh krizën aktuale dhe pa dashje rrezikojnë që të kaluarën e Kosovës ta shohin vetëm si parahistori të konfliktit të sotëm, si proces teologjik, i cili “logjikisht” duhet të përfundojë në përlëshje. Përveç kësaj, këto vepra koncentrohen fuqishëm në historinë e politikës dhe ngjarjeve dhe kështu ndjekin traditën e shkencës serbe dhe shqiptare të historisë.

Ky libër përpiket të ofrojë një qasje tjetër. Këtu nuk ofrohet një paraqitje e pastër kronologjike - ndonëse kjo qasje nuk mund të shmanget dhe boshti kohor përherë ka qenë një dimension qendror i vështrimit historik - por në qendër të vëmendjes gjenden strukturat hapësinore, shoqërore dhe kulturore të rajonit historik të Kosovës.

Ndërtimi i librit ndahet në dy pjesë kryesore dhe në një vështrim të përgjithshëm mbi zhvillimet e fundit (1999-2008): në pjesën e parë bëhet përpjekje për të shkruar një histori strukturore të paramodernes. Ajo në Kosovë zgjat së paku deri në përfundim të perandorisë së fundit të madhe, Perandorisë Osmane (1912). Përballë nivelit shpesh të pamjaftueshëm të studimeve, analiza nuk mund të shtrihet në mënyrë të barabartë nëpër gjithë hapësirën e vështrimit prej epokës së romakëve

deri në fund të sundimit osman. Qëllimisht nuk vihen në plan të parë gjuha dhe kombi, të cilat si kategori interpretimi dhe perceptimi dalëngadalë fituan rëndësi tek në 130 vitet e fundit. Këtu nuk kemi për të përshkruar grupe të armiqësuar etnike, por një shoqëri të shtresëzuar pas ndarjeve të ndërlikuara territoriale, shoqërore, ekonomike dhe kulturore, një shoqëri në të cilën identitetet etnonacionale u krijuan tek nga fundi i shekullit të 19-të në një proces të gjatë dhe jo pa thyerje. Kështu, njëkohësisht hapet edhe një pamje tjetër ndaj gjendjes aktuale. Pa e mohuar situatën aktuale të konfliktit, ajo, megjithatë, integrohet në një kornizë të gjerë historike.

Pjesa e dytë i kushtohet shekullit të 20-të, kur gjatë ekzistimit të dy Jugosllavive (1918-1941; 1945-1999) arrihet një shkallë e re e konsolidimit të sundimit, e depërtimit politiko-administrativ, e mobilizimit të dhunshëm të shoqërisë dhe strategjive modernizuese të shtyra nga shteti. Të gjitha këto shkundën themelet e strukturave paramoderne. Edhe në këtë pjesë më shumë rëndësi u kushtohet zhvillimeve afatgjata sesa historisë së thjeshtë politike. Po ashtu bëhet përpjekje që nacionalizimi i shoqërisë në Kosovë - pra, transformimi i identiteteve paramoderne religjioze, përkatësisht socioekonomike në identitete etnonacionale - të prezantohet duke pasur parasysht sfodin e strukturave paramoderne sociokulturore. Më së voni nga vitet '80 ngjarjet politike ndikojnë aq fuqishëm në zhvillimet strukturore, sa që atyre duhet kushtuar vëmendje më të madhe. Thyerjet vendimtare në strukturat socioekonomike u shkaktuan nga motivet politike: shembulli më i mirë janë trazirat e vitit 1981, kur shqiptarët e Kosovës shkaktuan një krizë të rëndë në Jugosllavi. Një kohë të gjatë kjo kryengritje u interpretua në radhë të parë si shprehje e protestës kundër mjerimit social. Kjo është në të vërtetë e saktë, por kohëve të fundit është bërë deri diku e qartë se rebelimi u shkaktua mbas edhe nga udhëheqja shtetërore e Republikës Popullore të Shqipërisë, me qëllim që të destabilizohet Jugosllavia. Një vit para trazirave, Shqipëria, sipas një ushtaraku të asaj kohe, tashmë kishte përgatitur plane për të sulmuar Jugosllavinë. Prandaj, prezantimi në pjesën e fundit të librit duhet të ndërlihdë ngushtë historinë politike me atë strukturore.

Në kapitullin përfundimtar përshkruhet protektorati i Kombeve të Bashkuara, për të cilin vlejné mendime të njëjta metodologjike.

Kush merret me historinë e Kosovës, pashmangshëm duhet të për-

ballet me probleme të dukshme metodologjike: në kufijtë e saj të tanishëm Kosova ekziston pak a shumë tek nga viti 1945. Kur trajtohen epokat e mëhershme, përdoret si të thuash një kornizë artificiale hapësinore. Shumë zhvillime nuk mund të përthekohen me kufijtë e sotëm: kështu Kosova Veriore dhe territori i Sanxhakut të Novi- Pazarit (sot në Serbi) me shekuj përbënin një njësi territoriale dhe kulturore, ndërsa - për shembull - marrëdhëniet e periferisë perëndimore të Kosovës së sotme me malësinë shqiptare dhe me Shkodrën si qendër e Shqipërisë Veriore kanë qenë më të rëndësishme sesa me pjesën lindore të Kosovës së sotme; pjesa jugore e Kosovës i takonte sferës dominuese të kryeqytetit të sotëm maqedonas, Shkupit. Andaj është metodologjikisht e papërshtatshme të merren parasysh kufijtë e sotëm.

Edhe më e vështirë situata paraqitet sa i përket hulumtimit shkencor: mbi konfliktet etnonacionale dhe historinë demografike, e cila është e interpretuar sipas kutitë etnik, ekzistojnë disa punime; mirë e hulumtuar është edhe historia e sundimit mesjetar serb. Për dallim nga kjo ekzistojnë vetëm pak hulumtime kuptimplota mbi sundimin osman që zgjati katër shekuj e gjysmë. Dy Jugosllavitë (1918-1941; 1945-1999) janë hulumtuar kryesisht në lidhje me konfliktet etnike; temat si politika e popullimit dhe arsimit janë hulumtuar hollësisht. Nga ana tjetër, mungojnë pothuaj tërësisht punime mbi historinë sociale dhe ekonomike. Historia e përditshmërisë, e gjinive dhe e ambientit janë fusha studimore të paprekura. Ndryshimet e thella shoqërore, veçanërisht në Jugosllavinë socialiste (industrializimi, urbanizimi, ndryshimi i roleve të gjinive, transformimi i kulturës materiale) pothuaj nuk merren parasysh nga historianët rajonalë. Andaj, një libër që dëshiron të fokusohet sidomos në këtë fushë, gjithsesi futet në terren të pasigurt. Autori është i vetëdijshëm se shumë tema vetëm preken sipërfaqësisht për t'ia tërhequr vëmendjen lexuesit se historia e Kosovës nuk niset e bitiset me historinë e konfliktit dhe se shumë fusha ende duhet të trajtohen. Për këtë arsye duhet të pranohen zbrazëtitat dhe mungesat e shtjellimeve në pjesët strukturoro-historike.

Në fund, është e nevojshme të shpjegohet edhe titulli i librit: historia e Kosovës nuk mund të shkruhet si histori e izoluar e një rajoni apo një vendi. Kjo strukturë territoriale ekziston tek nga viti 1945, përkatësisht (në trajtë të kontestuar) nga viti 2008. Vetëm pak gjëra që prezantohen në faqet në vijim janë specifike për këtë rajon, por shumë gjëra

janë tipike për Ballkanin bizantino-osman në tërësinë e tij apo për zonat e mëdha rajonale (ta zëmë hapësira kulturore serbe dhe shqiptare). Andaj, është më e racionale që Kosova të vendoset në kontekste më të mëdha hapësinore, që ajo të shikohet në kuadër të historisë së trevave qendrore të Ballkanit. Autor i termit “treva qendrore ballkanike” është Edgar Hösch: me këtë ai mendon ish-Jugosllavinë (dhe atje, para së gjithash, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë), Shqipërinë, Bullgarinë dhe Greqinë Veriore (Epirin, Maqedoninë greke, Thrakinë). Në diskutimin mbi termin Evropë Juglindore, Holm Sundhussen në kuptimin e ngushtë i ka nxjerrë modelet sunduese të Bizantit dhe të Perandorisë Osmane si konstituive për strukturat sociokulturore të hapësirës evropiano-juglindore (domethënë, pa Hungarinë historike dhe pa hapësirën e banuar nga slovenët). Në këtë kornizë territoriale dhe metodologjike synon të renditet ky libër. Në vijim nuk do të paraqitet historia e izoluar e një rajoni me kufij të qartë, por një zhvillim, i cili qëllimisht është thurur në kontekst rajonal dhe po ashtu është hapur sa i përket kufizimit territorial të një treve qendrore ballkanike.

### **Koncepte konkurruese të historisë**

Dy grupet më të rëndësishme etnike, shqiptarët dhe serbët, e perceptojnë aq ndryshëm historinë e Kosovës, saqë interpretimet konkurruese jo vetëm që e përjashtojnë njëra-tjetrën, por përpiqen që grupin tjetër ta izolojnë në një qoshe, duke e prezantuar si të parëndësishëm, të pacivilizuar dhe të dhunshëm. Pasi që këto pikëpamje janë të ngulitura thellë te të dy grupet etnike dhe përmes medimeve e sidomos internetit kanë arritur të shpërndahen gjerësisht, ato do të prezantohen menjëherë këtu në formën e tyre ideale-tipike. Kështu synohet të evitohet që në çdo hap të ardhshëm përherë të shpjegohet edhe meta-niveli i interpretimeve konkurruese.

Konflikti i tanishëm rreth Kosovës zhvillohet me aq ashpërsi edhe për shkak se serbët dhe shqiptarët këtij rajoni i caktojnë një vend kyç në imazhin e tyre kombëtar të historisë dhe e shikojnë Kosovën si territor thelbësor të kulturave të tyre të veçanta. Të kuptuarit e tillë të rajonit detyrimisht e bën tjetrin të duket si pushtues dhe si kërcënim elementar. Me gjithë dallimet përmbajtjesore, modelet e mendimit të të dy imazheve mbi historinë kombëtare në shumë gjëra janë befasisht të njëjta, pasi

që ndjekin skemën, e cila mund të vëzhgohet edhe te nacionalizmat e tjerë. Figurat kryesore të interpretimit janë: autoktonia - grupi im është qëmoti banor këtu; prioriteti kohor - grupi im ka qenë së pari këtu; vazhdimësia e banimit - grupi përherë ka banuar në këtë territor; epërsia kulturore, përkatësisht në rastin serb: misioni i civilizimit - grupi im ka vlerë më të madhe kulturore dhe civilizuese për dallim nga tjetri që perceptohet si barbar.

Imazhi serb i historisë është zhvilluar nga shekulli i 19-të dhe ushqehet kryesisht nga një traditë e trashëguar kombëtare, e formësuar nga folklori, domethënë gojarisht dhe posaçërisht nga kënga popullore dhe nga shkenca e dijeve humane, e cila lulëzoi që nga fundi i shekullit të 19-të. Kjo shkencë kontribuoi në mënyrë thelbësore në përhapjen e pikëpamjes serbe edhe përtej Ballkanit. Pasi që në hapësirën e banuar me shqiptarë para vitit 1945 nuk kishte institucione shkencore, siç janë universitetet apo akademitë, elita serbe kishte një epërsi të madhe dhe një avantazh kohor në propagandimin e imazhit të saj për Kosovën. Pasi disa shkencëtarë serbë gëzonin prestigj të lartë ndërkombëtar, interpretimet e tyre depërtuan edhe në diskutimet shkencore ndërkombëtare dhe kështu hynë edhe në shumë prezantime të rëndësishme mbi Evropën Juglindore.

Në vazhdim do të paraqiten konceptet historike të serbëve dhe shqiptarëve dhe, më këtë rast, me vetëdije do të përdoren termat, të cilët janë të zakonshëm për traditat përkatëse të interpretimit. Duhet theksuar se këtu prezantohen vetëm vijat themelore dhe se si vërehen te serbët ashtu edhe te shqiptarët shumë nuanca, sidomos në lidhje me vlerësimin e historisë së re. Po ashtu nuk mbahen të fshehura as kundërtëheniet e brendshme të interpretimeve përkatëse. Skicat në vazhdim japin një imazh qëllimisht të theksuar, siç është i përhapur, para së gjithash, në medime dhe (sidomos te shqiptarët e Kosovës) në libra shkollorë. Po ashtu këtu merret parasysh edhe gjuha zakonisht emocionale dhe pak e diferencuar si dhe devijimet sa i përket logjikës së argumentimit. Dy paragrafët e ardhshëm prezantohen në shkronja kursive me qëllim që të shquhen si pjesë e veçantë e librit dhe kjo të bëhet e dukshme edhe nga aspekti grafik.